LIGJ
Nr.7580, datë 7.7.1992

PËR MIRATIMIN E MEDALJES SË ARTË "PISHTAR I DEMOKRACISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 24.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratimin e medaljes së artë "Pishtar i demokracisë".

Neni 2

Medalja e artë "Pishtar i demokracisë" u jepet shtetasve shqiptarë ose me kombësi shqiptare dhe shoqatave a organizatave patriotike për shërbime veçanërisht të shquara e sakrifica supreme atdhetare, të kryera në shërbim të idealeve të larta të kombit shqiptar e të demokracisë".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.247, datë 11.7.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha